



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:021047  
Datë: 08.07.2024  
Numri i dokumentit: 05909336

**C.nr.398/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtaren Edije Seziri, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.B. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson K.M. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore e Komuna, V.I.Xh. me objekt të padisë kompensim për shpërblimin jubilar, vlera e kontestit 1,034.18 euro, jashtë seance, me datë 01.07.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Sh.B. nga Prizreni.

**II. DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Sh.B. nga Prizreni, në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune, ti paguaj shumën prej 631.50 € (gjashtëqind e tridhjetë e një euro, e pesëdhjetë cent) apo 150% të pagës bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 19.01.2024, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar, në lartësi prej 1,034.18€, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, **refuzohet si e pabazuar**

**IV. DETYROHET** e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 € (njëqind e tridhjetë e katër), në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditëja Sh.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj K.M. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datë 19.01.2024, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimi i pagës jubilar, vlera e kontestit 1,034.18 euro.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësit ka themeluar kontratë pune pranë shkollës “Dëshmorët e Zhurit” në Prizren, me mbi 43 vite përvojë pune dhe e njëjta vazhdon të punoj sot e kësaj dite dhe të cilit i mundësohet kompensimi i viteve jubilar, ashtu si parashihet

me nenin 35 par.8 të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë. Edhe pse paditësja i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, i njëjti nuk ka marrë përgjigje. Prandaj gjykatës i ka propozuar, që të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditësit, ta aprovojë në tërësi sitë bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e pagës jubilarë. E njëjta ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/488, të datës 21.11.2022, për Shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtar i sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: vërtetimin me numër 379/23, të datës 11.12.2023, të lëshuar nga drejtori i SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, përmes vërtetimit me numër 379/23, të datës 11.12.2023, ka vërtetuar faktin se paditësja Sh.B. është në marrëdhënie pune pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, komuna e Prizrenit dhe e njëjta i ka 43 vite përvojë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit me numër 166, të datës 25.08.2022, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me përvojën e punës për këtu paditësen Sh.B.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me numër të njësisë 01B, numër të prot.105, të datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër të njësisë 01B, numër të prot.105, të datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve (antarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimi të përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit: dhe atë “për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë; për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë” .

Gjykata, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”, pasi që vlerësoi se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses Sh.B. nga Prizreni, si punëtorë i arsimit-mësimdhënës, në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune, t’ia paguaj kompensimin në vlerë të 150 % të një pagë bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €), duke u bazuar në KKAK-së të datës 22.01.2021, pasi që paditësja, bazuar në vërtetimin me numër 379/23, të datës 11.12.2023, i ka arritur 40 vite të përvojës.

Gjykata, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitën ligjore 399 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.”, pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, ku rezultoi se kërkesëpadija e paditësit përtej shumës së aprovuar në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, deri në shumën e përgjithshme të kërkuar, në lartësi prej 1,034.18 euro, të refuzohet si e pabazuar, pasi që paga bazë, 150 % e të cilës duhet ti kompensohet paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune është në lartësi prej 421.00 euro, kjo duke u bazuar në faktin se paga bazë për mësimdhënësit në Republikën e Kosovës ka qenë në lartësi prej 421.00 euro dhe jo në lartësinë e kërkuar prej 689.43 euro (e cila paraqet pagën mujore të paditëses).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (20.09.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, lidhur me pjesën aprovuese sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqësore dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 € dhe taksës gjyqësore në

Numri i lëndës: 2024:021047  
Datë: 08.07.2024  
Numri i dokumentit: 05909336

shumën prej 30.00 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 134.00 € (njëqind e tridhjetë e katër).

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143, lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.398/2024 datë 01.07.2024**

**Gj y q t a r j a**  
**Edije Sezairi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.